

V E N D I M
Nr. 81, datë 6.2.2003

PËR SHITJE TRUALLI, KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 3 e të paragrafit të parë, të nenit 8 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë t’i shitet trualli me sipërfaqe prej 966 m2 në qytetin e Tiranës, në pjesën lindore të pronës së kësaj kishe, sipas gentplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Çmimi i shitjes së truallit të jetë 1 600 lekë/m2.
 3. Ngarkohet Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano